



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR

**KODIN E SJELLJES PËR INTEGRITET NË KËRKIMIN SHKENCOR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Kodi i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë përmban parimet dhe normat themelore të sjelljes së institucioneve akademike e kërkimore dhe punonjësve akademikë e kërkuesve shkencorë në Republikën e Shqipërisë.

Kodi i Sjelljes synon të ruajë, të garantojë dhe të mbrojë pastërtinë dhe integritetin akademik, profesional, institucional, moral dhe shoqëror të institucioneve dhe të pjesëtarëve të komuniteteve akademike e shkencore.

Kodi shndërron në normë ligjore Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, miratuar në vitin 2017, i cili shërben si një kornizë vetërregulluese për ushtrimin dhe mbajtjen e përgjegjësive ligjore të institucioneve dhe të pjesëtarëve të komuniteteve akademike e shkencore.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për Kodin e Sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”

Kodi niset nga premisa se kërkimi shkencor, sidomos dhënia e gradave shkencore dhe e titujve akademikë në Shqipëri ka nevojë për një proces “Vetting”-u dhe Kodi garanton zhvillimin e tij.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kodi Evropian i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor është miratuar në vitin 2017 nga ALLEA-All European Academies (Shoqata e Akademive Europiane), në të cilën është anëtare edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Kodi është i detyrueshëm për tu zbatuar nga të gjitha akademitë anëtare të ALLEA-s.

Hartimi i Kodit niset nga premisa se standardet që përmban Kodi Evropian i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor nuk mund të zbatohen nëse zbatimi i tyre kërkohet ose interpretohet vetëm si një kërkesë dhe si një standard moral.

Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor dhe garantimi i integritetit të tij kërkon:

- a) shndërrimin e standardeve etiko-morale në norma ligjore, të detyrueshme për zbatim;
- b) evidentimin e shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor;
- c) diferencimin e shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor;
- d) përcaktimin e sanksioneve për shkeljet e rënda dhe shkeljet e tjera të integritetit të kërkimit shkencor;
- e) ngritjen e organeve disiplinore që vendosin sanksione ndaj shkeljeve të integritetit të kërkimit shkencor dhe përcaktimin e kompetencave të tyre.

Kërkimi shkencor në Shqipëri ndeshet me probleme serioze që kanë të bëjnë, përveç të tjerash, me shkelje e dëmtime serioze të cilësisë dhe integritetit të tij.

Këto shkelje kanë të bëjnë me shumë aspekte, por shkeljet më të rënda konstatohen në rastet e fabrikimit të rezultateve të kërkimit shkencor, falsifikimit të tyre dhe, mbi të gjitha, plagjiaturës.

Institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore nuk kanë pasur as vëmendjen, as bazën ligjore, as kapacitetet institucionale dhe as burimet e nevojshme njerëzore e financiare për të ruajtur cilësinë dhe integritetin e punimeve shkencore dhe botimeve të tyre. Masivizimi i dhënies së gradave e titujve shkencore nuk është shoqëruar nga krijimi i “filtrave” ligjorë, institucionalë dhe moralë të garantimit të cilësisë së tyre.

Për pasojë, vlerat shkencore dhe fuqia në treg e gradave shkencore dhe titujve akademikë, madje edhe e diplomave “Bachelor” dhe “Master” të dhëna në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, janë të dobëta.

Kodi synon të vendosë rregulla të forta në këtë proces, në formën e normave ligjore të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet arsimore e kërkimore si edhe nga të gjithë titujve kërkuesit, oponentët dhe udhëheqësit e kërkimit shkencor dhe të mbrojtjes së gradave e shkencorë.

Cilësia dhe integriteti i kërkimit shkencor nuk lidhet vetëm më plotësimin e normativave ligjore, por edhe të standardeve intelektuale, integritetit dhe të cilësisë.

Miratimi i Kodit pritet të sjellë rritjen e cilësisë, integritetit si edhe të dobisë praktike të veprimtarisë kërkimore dhe të gradave e titujve shkencorë në Shqipëri, në mbështetje të zhvillimit të vendit dhe të shkencës shqiptare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, posaçërisht nenin 58, i cili garanton se liria e kërkimit shkencor mbrohet me ligj, dhe nenin 59, i cili përcakton se shteti synon mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Projektligji është në përputhje të plotë si dhe me të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi.

Kodi është në sinergji e sintoni me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë, ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, projektligjin për Akademinë e Shkencave, i cili

paraqitet për miratim së bashku me Kodin e Sjelljes, si edhe legjislacionin për kërkimin shkencor në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji reflekton standardet dhe praktikat më të mira evropiane, si dhe parimet e veprimtarisë shkencore evropiane.

Kodi është në përputhje të plotë me standardet dhe kërkesat e Kodit Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, 2017.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Kreu i Parë titullohet “**Dispozita të përgjithshme dhe përkufizime**” dhe përcakton objektin, qëllimet, fushën e zbatimit, premiset nga niset, si edhe përkufizimet kryesore të Kodit.

Kreu i Dytë titullohet “**Parimet e veprimtarisë akademike dhe të kërkimit shkencor**” dhe përmban përcaktimet mbi lirinë akademike dhe të kërkimit shkencor; përgjegjësinë e komuniteteve kërkimore e akademike; parimet e kërkimit shkencor, si garancia për cilësinë e kërkimit, ndershmëria në zhvillimin dhe komunikimin e rezultateve me transparencë, drejtësi dhe paanshmëri, respekti për kolegët, kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, përgjegjësia shoqërore për kërkimin; praktikat e mira në kërkimin shkencor, të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në aspektet e mëposhtme, si mjedisi i kërkimit, trajnimin për kërkimin, udhëheqjen e kërkimit dhe të studiuesit, procedurat e kërkimit, mbrojtjen e studiuesit, përdorimin e të dhënave, botimin e rezultateve të kërkimit, vlerësimin e kërkimit etj.

Kreu i tretë titullohet “**Procedurat në veprimtarinë akademike dhe në kërkimin shkencor**” dhe përmban përcaktimet mbi parimet e procedurave të kërkimit shkencor, respektimin dhe masat mbrojtëse në kërkimin shkencor, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave, kriteret e përfshirjes, përgjegjësinë e përbashkët dhe bashkautorësinë në kërkimin shkencor, si edhe shmangia e konfliktit të interesit në vlerësimet për punimet dhe gradat e titujt shkencorë.

Kreu i katërt titullohet “**Shkeljet e integritetit në kërkimin shkencor. Verifikimi, shqyrtimi dhe sanksionet**” dhe përmban përcaktimet mbi shkeljet e rënda të integritetit në kërkimin shkencor, si fabrikimi ose sajimi i rezultateve të kërkimit

dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta; falsifikimi manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja a shmangia e të dhënave ose e rezultateve, në mënyrë të pajustificuar ose prezantimi i një punimi ose botimi si me vlera shkencore, pa qenë i tillë; plagjiatura ose përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale; pranimi dhe/ose paraqitja e punimeve pranë një organi haptazi jo kompetent a i pa autorizuar në fushën përkatëse.

Ky krye përmban gjithashtu edhe përcaktimet mbi shkeljet e tjera të integritetit në kërkimin shkencor, si manipulimi i autorësisë; autoplagjiatura; citimi përzgjedhës; fshehja e pjeshme e rezultateve të kërkimit; lejimi i financuesve/sponsorizuesve të rrezikojnë pavarësinë e procesit të kërkimit ose të raportimit të rezultateve; keqprezantimi i arritjeve të kërkimit; themelimi ose mbështetja e revistave a botimeve të tjera grabitqare; fshehja e konfliktit të interesit etj.

Në këtë krye përcaktohen edhe procedurat e verifikimit dhe të shqyrtimit të shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor; organet disiplinore për etikën pranë institucioneve kërkimore e akademike; garantimin e të drejtës për ankim, kompetencat, përbërjen dhe procedurat e zgjedhjes së Kolegjit të Etikës pranë Akademisë së Shkencave, si organi që shqyrton ankimet e palëve ndaj sanksioneve për shkeljet e integritetit në kërkimin shkencor, duke nënvizuar se Kolegji i Etikës mund të shqyrtojë shkeljet e integritetit në kërkimin shkencor edhe me nismën e tij. Kreu përcakton edhe sanksionet ndaj shkeljeve dhe shkeljeve të rënda të integritetit në kërkimin shkencor, duke përcaktuar se ndaj autorëve të punimit, oponentëve dhe udhëheqësve shkencorë, për të cilët provohet se kanë kryer shkelje të rënda ose shkelje të integritetit në kërkimin shkencor, vendosen sanksione financiare ose sanksione të tjera, të cilat nisin nga gjobat në lekë, rishikimin e kontratës së punës, ndërsa për shkeljet e rënda të konstatuara në punimet ose dokumentacionin e mbrojtjes së gradave ose titujve shkencorë, vendoset heqja e gradës ose e titullit shkencor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Projektligji ngarkon për zbatimin e tij Këshillin e Ministrave, ministrinë përgjegjëse për shkencën, Akademinë e Shkencave, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore, organizatat dhe shoqatat e dijes, si dhe kërkuesit që kryejnë kërkim publik e privat, botuesit dhe organet e tjera të lidhura me veprimtarinë akademike e kërkimore të cilët zhvillojnë dhe mbajnë përgjegjësitë e

veta në vëzhgimin dhe zbatimin e parimeve dhe praktikave të sjelljes me integritet në kërkimin shkencor.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Projektligji u hartua nga grupi i punës i ngritur nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe nga komisioni ad hoc i ngritur nga Asambleja e Akademisë së Shkencave.

Projektligji iu nënshtrua një procesi konsultimesh me akademikë, përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë, qendrave dhe instituteve kërkimore, shoqërisë civile, sektorit privat etj.

Projektligji u diskutua dhe u miratua në parim dhe nen për nen edhe me drejtues dhe përfaqësues të ALLEA-All European Academies (Shoqata e Akademive Evropiane), si edhe Akademisë së Gjermanisë “Leopoldina”.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon rritje të shpenzimeve buxhetore për Akademinë e Shkencave.

Projektligji nuk parashikon rritje të shpenzimeve buxhetore për institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat kërkimore dhe për asnjë institucion që ngarkohet për zbatimin e tij.

Projektligji parashikon shpenzime buxhetore vetëm për funksionimin e Kolegjit të Etikës, i cili parashikohet të ngrihet e konstituohet prej ministrisë përgjegjëse për shkencën, pranë Akademisë së Shkencave, dhe me një linjë buxhetore brenda buxhetit të ministrisë përgjegjëse për shkencën.

PROPOZUESI

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR